



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË
KRYESIA

Nr. 278 / prot.

Tiranë, më 25. 07. 2019

Vendim

nr. 15 datë 25.07 2019

Për formimin e jurisë së konkursit retrospektiv për veprën shkencore më cilësore për antifashizmin në Shqipëri, botuar në periudhën 1991-2019

Në kuadër të përkujtimit të 75-vjetorit të antifashizmit në Shqipëri

- Drejtuar :**
- Jurisë së konkursit
 - Universiteteve, institucioneve dhe qendrave kërkimore-shkencore, shtëpive botuese, kërkuesve shkencorë të pavaruar.
 - Akademisë së të Rinjve;
- Për dijeni:**
- Asamblesë së Akademisë së Shkencave, anëtarëve të saj, drejtuesve të seksioneve shkencore, sektorit të botimeve shkencore dhe bibliotekës, sektorit të financës dhe sektorit të personelit;

Referuar pikës 4 të Vendimit Nr. 14, datë 24 korrik 2019 *Për shpalljen e konkursit retrospektiv për veprën shkencore më cilësore për antifashizmin në Shqipëri, botuar në periudhën 1991-2019"* të Kryesisë së Akademisë së Shkencave;

1. Pranë Akademisë së Shkencave formohet juria ndërkombëtare e konkursit retrospektiv për veprën shkencore më të realizuar kushtuar antifashizmit në Shqipëri (nga viti 1991 deri më 2019), me këtë përbërje:

| Nr. | Emri dhe mbiemri | Institucioni |
|-----|---------------------------|---|
| 1. | Akad. Floresha Dado | Akademia e Shkencave e Shqipërisë, ASHSH |
| 2. | Akademik Jusuf Bajraktari | Përfaqësues i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës ASHAK |
| 3. | Prof. dr. Valentina Duka | Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë |
| 4. | Dr. Mario Brunetti | <i>Itinerari Gramsciani</i> |
| 5. | Prof. dr. Hamit Kaba | Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, ASA |

2. Veprimtaria

e jurisë bazohet në rregulloren *Për themelimin e çmimeve vjetore shkencore kombëtare të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë; për mënyrën e organizimit të konkurseve; për kriteret e zgjedhjes së fituesve dhe mënyrën e shpalljes së tyre*, miratuar me urdhrin nr. 11 datë 6 tetor 2016 të kryesisë së ASH-së.

3. Çmimet i jepen veprës më cilësore shkencore pa kufizim nëse autori i saj është në jetë apo jo. Çmimi për veprën më cilësore për të rinjtë jepet për studiues deri në moshën 40 vjeç,. Juria merr vendime në mënyrë autonome për përzgjedhjen e titujve, nominimin dhe shpalljen e fituesve.

4. Mbledhja e parë e jurisë bëhet jo më vonë se data 1 shtator 2019. Në mbledhjen e parë juria zgjedh kryetarin, bën ndarjen e detyrave dhe miraton kalendarin e konkursit, në përputhje me vendimin për shpalljen e tij.

5. Juria i zhvillon mbledhjet e saj në sallën *Akademikët*. Mbledhjet e jurisë asistohen nga sekretaria teknike. Ngarkohet sektori i botimeve dhe i bibliotekës shkencore të caktojë në këtë detyrë një punonjës të tij. Sekretaria mban, zbardh dhe u paraqet për miratim procesverbalin anëtarëve të jurisë.

6. Juria komunikon me shtypin dhe mediat për rezultatet dhe vendimet e ndërmjetme përmes kryetarit të saj.

7. Vendimet për nominim dhe për shpalljen e fituesve bëhen me votim të fshehtë. Anëtarët e jurisë do të shpërblehen për angazhimin e tyre.

8. Ngarkohet specialisti i komunikimeve shkencore dhe i marrëdhënieve me jashtë e publikun për njoftimin e këtij vendimi.

9. Ngarkohet specialisti IT për publikimin e këtij vendimi.

10. Ngarkohet sekretari shkencor për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Zëvendëskryetar

Akademik Vasil S. TOLE

Vasil S. Tole

